



REPUBLIKA E SHQIPERISE

AUTORITETI KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

DREJTORIA E RREGULLIMIT EKONOMIK

TREGUESIT STATISTIKORE

TE TREGUT TE KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

6 MUJORI I-rë 2010

TELEFONI CELULARE

TELEFONI FIKSE

INTERNET

Publikimi: Tetor 2010

I.HYRJJE	3
II. PANORAMË E PËRGJITHSHME	4
III.1 Pjesët e tregut të operatorëve celularë	8
III.3 Trafiku telefonik	13
III.4 Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare	15
III.5 Përdorimi shërbimeve të tjera celulare	17
III.6 Dimensioni i rrjeteve celulare.....	18
IV.1 Numri i pajtimtarëve dhe pjesët e tregut.....	19
IV.2. Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve të Altelecom	20
V. INTERNETI	22
V.1. Numri i pajtimtarëve me akses broadband në Internet dhe struktura e tyre	22
V.2. Ofrimi me shumicë i aksesit në Internet dhe infrastruktura.....	24

Figura 1: Numri përdoruesve të telefonisë celulare dhe fikse (2003-2010/1)	5
Figura 2: Penetrimi i telefonisë celulare dhe fikse (2003-2010/1).....	5
Figura 3: Krahasimi Shqipëri-BE ;Telefoni celulare, fikse dhe akses broadband në Internet	6
Figura 4: Të ardhurat totale të operatorëve të komunikimeve elektronike 2009.....	7
Figura 5: Numri përdoruesve celulare 2003-2010/1	8
Figura 6: Të ardhurat dhe pjesët e tregut të operatorëve celulare 2009	9
Figura 7: Të ardhurat e operatorëve celulare 2003-2009	9
Tabela 1. Pjesët e tregut të operatorëve celulare 2010/1.....	10
Figura 8: Struktura e përdoruesve celulare 2010/1.....	11
Figura 9: Struktura e përdoruesve celulare dhe pjesët e tregut 2010/1	12
Figura 10: Trafiku dales celular sipas destinacioneve 2003-2010/1	13
Figura 11: Trafiku hyrës celular sipas origjinës 2003-2010/1	14
Tabela 2: Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare 2006-2010/1	15
Figura 12: Përdorimi Mesatar mujor për përdorues sipas operatorëve 2006-2010/1	16
Tabela 3: Numri dhe kohegjatja mesatare e thirrjeve celular në total (2009-2010/1).....	17
Tabela 4: Përdorimi i shërbimeve roaming ndërkombëtar 2010/1	17
Tabela 5. Tregues të dimensionit të rrjeteve celulare 2010/1	18
Figura 13: Numri pajtimtarëve të telefonisë fikse (2003-2010/1)	19
Tabela 6. Pjesët e tregut të Altelecom dhe Operatorëve Alternative.....	20
Tabela 7 Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve të Altelecom 2003-2010/1	20
Tabela 8. Numri i pajtimtarëve me akses broadband në Internet (2010/1).....	23
Tabela 9. Klasifikimi i pajtimtarëve me akses broadband sipas teknologjive 2010/1	24
Tabela 10. Ofrimi i aksesit në Internet në nivel me shumicë 2010/1.....	25

I.HYRJE

AKEP, me qëllim informimin e publikut, palëve të interesuara dhe të sipërmarrësve të tregut të komunikimeve elektronike me treguesit kryesorë të këtij tregu, në vijimësi të raporteve periodike vjetore për 2008 dhe 2009, ka përgatitur këtë dokument në të cilin publikohen statistika dhe treguesit kryesorë të tregut për 6 mujorin e parë të vitit 2010 dhe ndryshimet me periudhat e mëparshme.

Ky dokument është përgatitur duke iu referuar të dhënave të dërguara nga operatorët celularë, Albtelecom si dhe të dhënave të Operatorëve Alternativë dhe Ofruesve të shërbimeve, sipas formularëve të Rregullores së të dhënave statistikore, të plotësuar nga sipërmarrësit e autorizuar nga AKEP.¹ Për shkak të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave, jo të gjithë treguesit e raportuar nga operatorët publikohen nga AKEP.

Dokumenti ka natyrë periodike dhe mund të pasurohet edhe me tregues të tjerë apo informacion statistikor më të plotë për operatorët alternative dhe tregun në tërësi.

¹ Për shkak të problemeve të mos-dërgimit të të dhënave apo të dhënave jo-të plota nga një numër i konsiderueshëm i operatorëve alternativë, disa tregues për këta operatorë bazohen në vleresimet e AKEP.

II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Numri i sipërmarrësve të cilet kanë njoftuar AKEP për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike deri më 01.07.2010 është 182, në krahasim me 152 që ishte në fund të vitit 2009. Numri i sipërmarrësve sipas shërbimeve kryesore:

- Rrjete dhe shërbime të telefonise fikse: 86
- Shërbim Interneti: 96
- Rrjete publike të telefonise celulare: 4

Gjatë gjashtëmujorit të parë 2010 telefonia celulare dhe aksesit broadband në Internet kanë shënuar rritje në numrin e pajtimtarëve, ndërsa telefonia fikse për herë të parë ka shënuar rënie.

Në fund të gjashtëmujorit të I-rë 2010, numri përdoruesve të telefonisë së lëvizshme arriti në **4,413,083** përdorues, e cila përbën një rritje të ndjeshme me afërsisht **6 %** me fund vitin 2009 dhe 25% me gjashtëmujorin e I-rë 2009.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse ka shënuar rënie, për shkak të zvogëlimit me rreth 5 mijë pajtimtarë të Albtelecom. Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse, vlerësohet të jetë 360 mijë, prej të cilëve 70 mijë për operatorët alternativë.

Numri i përdoruesve me akses broadband në Internet ka shënuar rritje, duke arritur në 110 mijë, prej të cilëve 100 mijë familje, e cila përbën një penetrimit prej 3.4% për banorë dhe 12.5% për familje krahasuar me 2.5% dhe 10% në fund të vitit 2009.

Referuar të dhënave të Instat për numrin e popullsisë (projeksionet e REPOBA), si dhe të dhënave për tregun e telefonisë së lëvizshme dhe asaj fikse 2003-2010/1, janë përlllogaritur vlerat e penetrimit të telefonisë së lëvizshme dhe telefonisë fikse (numri i përdoruesve për 100 banorë). Në fund të gjashtëmujorit të parë 2010 penetrimi i telefonisë së lëvizshme është 136 %, kurse penetrimi i telefonisë fikse është **11%**.

Figura 1: Numri përdoruesve të telefonisë celulare dhe fikse (2003-2010/1)






Figura 2: Penetrimi i telefonisë celulare dhe fikse (2003-2010/1)



Normat e penetrimit (numri i abonenteve për 100 banorë) të shërbimeve të telefonise fikse dhe të aksesit apo linjave broadband janë shumë më të ulëta se në vëndet e BE, megjithë rritjen në aksesin broadband, ndërsa për telefoninë celulare norma e penetrimit është mbi nivelin mesatar të vëndeve të BE.

Figura 3: Krahasimi Shqipëri-BE ;Telefoni celulare, fikse dhe akses broadband në Internet




Të ardhurat totale të sipërmarrësve për vitin 2009 ishin 61578 milion LEK, që përbën një rritje të vogël në krahasim me vitin 2008 ku të ardhurat ishin 61387 milion lek².

Kater lojtarët kryesore, AMC, Vodafone Albania, Eagle Mobile (tre operatorë celulare) dhe Albtelecom (operatori fiks incumbent), vazhdojnë të zotërojnë pjesën më të madhe të tregut me 95% të të ardhurave të gjithë sektorit. Të ardhurat e operatorëve celulare përbëjnë 77% të të ardhurave të të gjithë tregut, ndërsa operatori fiks Albtelecom zotëron 18%, ndërsa operatorët alternative 5%. Ndër operatorët alternative, tre sipërmarrësit me xhiro më të madhe janë Primo, ASC dhe Abcom, të cilët së bashku zënë 2.5% të të ardhurave të sektorit apo 50% të të ardhurave të të gjithë operatorëve alternative.

² Të ardhurat për vitin 2008 bazohen në të ardhurat e raportuara nga 75 subjekte, ndërsa të ardhurat për vitin 2009 janë raportuar nga 65 subjekte.

Figura 4: Të ardhurat totale të operatorëve të komunikimeve elektronike 2009



Gjatë vitit 2009 të ardhurat totale të operatorëve celulare kanë pësuar reduktim me 3.6% ndërsa janë rritur të ardhurat e Albtelecom dhe të operatorëve me 14% dhe 16%, respektivisht.

Megjithëse në vitin 2009, rritja në xhiro/të ardhura të operatorëve duket se është e vogël (madje rënie për operatorët celulare), volumi i shërbimeve dhe përdorimi mesatar për abonent i telefonisë celulare dhe fikse janë rritur ndjeshëm krahasuar me vitin 2008 (për më shumë detaje shiko Informacion mbi tregun viti 2009), dhe kjo rritje ka vazhduar edhe në gjashtëmujorin e parë 2010:


- ♦ Minuta dalese nga rrjetet celulare janë rritur me 18% në krahasim me gjashtëmujorin e II-te 2009 dhe 175% në krahasim me gjashtëmujorin e I-re 2009.
- ♦ Komunikimi mujor për abonent celular: 95-170 minuta komunikim në muaj krahasuar me 100-130 minuta/muaj në vitin 2009
- ♦ Komunikimi mujor për abonent të telefonisë fikse (Albtelecom): 398 minuta përdorim (komunikim) apo afersisht 6.5 orë që përbën rritje me 25%, në krahasim me vitin 2009

III. TELEFONIA CELULARE

III.1 Pjesët e tregut të operatorëve celularë

Në fund të 6 mujorit I-rë të vitit 2010 numri përdoruesve të telefonise së levizshme arriti në 4,413,083 pajtimtarë në total duke rezultuar me një rritje prej 5.5 % krahasuar me fund vitin 2009 dhe 25% ne krahasim me gjashtëmujojin e I-rë 2009.


Figura 5: Numri përdoruesve celularë 2003-2010/1



Eagle Mobile ka rregjistruar rritjen më të madhe në numrin e përdoruesve me 16% në krahasim me fundin e vitit 2009 dhe 45% me gjashtëmujojin e I-re 2009, e cila ka çuar dhe në rritjen e pjesës së tregut të Eagle Mobile.


Te ardhurat totale të tre operatorëve celularë gjatë vitit 2009 janë 47.2 miliard lek, që përbën një reduktim me 3.6% në krahasim me vitin 2008, kur të ardhurat ishin 48.9 miliard leke. Rënia e të ardhurave për 2009 ka ardhur si rezultat i rënies së të ardhurave të AMC (15%) dhe Vodafone Albania (8%), ndërsa të ardhurat e Eagle Mobile janë rritur afërsisht 7 herë, duke rritur pjesën e tregut të Eagle Mobile nga 1% në vitin 2008, në 9% në vitin 2009.

Figura 6: Të ardhurat dhe pjesët e tregut të operatorëve celulare 2009



Ne figurën e mëposhtme paraqitet tendenca e të ardhurave celulare në periudhën 2003-2009, ku mund të vihet re se viti 2009 ishte viti i parë që shënoi rënie të të ardhurave të këtij segmenti të tregut.

Figura 7: Të ardhurat e operatorëve celulare 2003-2009



Në tabelën e mëposhtme paraqiten pjesët e tregut të tre operatorëve celularë për gjashtëmujorin e parë 2010 për treguesit e numrit të pajtimtarëve, thirrje dalëse, SMS dhe të ardhura (për vitin 2009). Vihet re se AMC ka pjesë tregu mbi 40% për të gjithë treguesit, ndërsa Vodafone ka pjesë tregu që variojnë nga 33-56%. Eagle Mobile si hyresi i ri në treg ka vazhduar rritjen e pjesëve të tregut në përdorues nga 14% në fund vitin 2009 në 16% në gjashtëmujorin e parë 2010, duke arritur dhe në 22% pjesë tregu për përdoruesit me kontratë, por vetëm me 2% për SMS.


Tabela 1. Pjesët e tregut të operatorëve celularë 2010/1

	Perdorues ne total	Parapagim	Parapagim Aktive	Kontrate	Thirrje dalese (minuta)	SMS	Te ardhura (viti 2009)
AMC	46%	47%	53%	43%	48%	42%	42%
Vodafone Albania	38 %	38%	37 %	35%	43%	56%	49%
Eagle Mobile	16 %	15%	10 %	22%	9%	2%	9%

III.2 Struktura e përdoruesve për Operatorët Celulare

Struktura e përdoruesve celulare, në përdorues me parapagim dhe me pas-pagim (kontratë), nuk vazhdon të jetë e qendrueshme dhe në gjashtëmujorin e parë 2010, numri i përdoruesve me kontratë në raport me numrin total të përdoruesve celulare, është afërsisht 7%. Struktura e përdoruesve celulare të AMC dhe Vodafone, nuk ka patur ndryshime dhe përdoruesit me kontratë përbëjnë 6% të numrit total të përdoruesve të tyre, ndërsa për Eagle Mobile përdoruesit me kontratë përbëjnë 9%.

Figura 8: Struktura e përdoruesve celulare 2010/1



Numri i përdoruesve celulare aktivë (përdoruesit që kanë përdorur shërbimet në tre muajt e fundit), është 3.65 milion, që është ndjeshëm më i ulët se numri i përdoruesve i matur me kartat SIM aktive të operatorëve³. Ky tregues është mbledhur për herë të parë nga AKEP, dhe nuk ka të dhëna për të krahasuar me periudhat e mëparshme. Nga të dhënat për numrin e përdoruesve aktive rezulton se EM ka pjesë tregu më të madhe se në numrin total të kartave SIM aktive (EM ka raportuar se të gjithë abonentët me parapagim janë aktive).

³ Secili operator ka politikën e veta komerciale të përcaktimit të kohës minimale të përdorimit të shërbimeve me parapagim për të konsideruar si kartë SIM aktive.

Figura 9: Struktura e përdoruesve celularë dhe pjesët e tregut 2010/1





Tabela e mëposhteme paraqet të dhëna për gjashtëmuajorin e parë 2010, mbi numrin e pajtimtarëve celularë të detajuar në abonentë Familjarë dhe Biznes si dhe përdoruesit e shërbimeve të aksesit në Internet dhe pajtimtarët që kanë ndërruar program tarifor brenda të njëjtit operator.

	AMC	VF-AL	EAGLE	Total
Numri pajtimtareve të telefonisë mobile në total i detajuar:	2,037,375	1,679,001	696,707	4,413,083
Perdorues familjare	1,949,278	1,573,972	591,279	4,114,529
Perdorues biznes	88,097	105,029	105,428	298,554
Numri i pajtimtareve që përdorin rrjetin celular për akses në Internet me GPRS/EDGE	835,356	39,049	175,022	1,049,427
Numri i Pajtimtareve që kanë ndërruar program tarifor në rrjetin tuaj	na	67,035	197,714	264,749

III.3 Trafiku telefonik


Në Fig.10 është pasqyruar trafiku telefonik i gjeneruar nga tre operatorët e rrjeteve celulare i detajuar sipas destinacionit të thirrjeve: brenda rrjetit, drejt rrjeteve të tjerë celulare, rrjete fikse dhe nderkombëtare. Në gjashtëmujorin e parë 2010 nga rrjetet celulare janë origjinuar 1.8 miliard minuta, e cila përbën një rritje me 18 dhe 175% në krahasim me gjashtëmujorin e II-te dhe të I-re, të vitit 2009, respektivisht. Vihet re se trafiku brenda rrjetit ka rritje të ndjeshme vjetore që prej vitit 2007 dhe kjo rritje ka vazhduar dhe në vitin 2009 dhe në gjashtëmujorin e parë 2010, ku thirrjet brenda rrjetit përbëjnë 92% të thirrjeve të origjinuara nga përdoruesit celulare, që përbën një rritje të konsiderueshme në krahasim me periudhën 2003-2006 në të cilin ky tregues ka qenë në nivel afersisht 50%. Rritja rezultoi të ketë ardhur si rezultat i ofertave dhe programeve të shumta tarifore që ofrojnë thirrje brenda grupeve me tarifa shumë të ulëta. Thirrjet drejt numrave gjeografike dhe numrave të emergjencës përbëjnë një pjesë shumë të vogël të thirrjeve dalëse.

Figura 10: Trafiku dales celular sipas destinacioneve 2003-2010/1



Në Fig.11 është pasqyruar trafiku telefonik hyrës në rrjetet e tre operatorëve celulare i detajuar sipas origjinës së thirrjeve: nga rrjete të tjera celulare, rrjete fikse dhe nderkombëtare (nuk janë përfshirë thirrjet brenda rrjetit). Në gjashtëmujorin e parë 2010 në rrjetet celulare janë terminuar 425 milion minuta, e cila përbën një reduktim me 10% dhe 5% në krahasim me gjashtëmujorin e II-te dhe të I-re të vitit 2009, respektivisht. Vihet re se struktura e këtyre thirrjeve ka qenë e qëndrueshme në vite dhe në gjashtëmujorin e parë 2010, nuk ka ndryshime thelbësore. Trafiku nderkombëtar hyrës, vazhdon të zëjë peshën kryesore në trafikun total hyrës me mbi 70%.

Figura 11: Trafiku hyrës celular sipas origjinës 2003-2010/1



III.4 Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare

Ne vijim janë dhënë tabela dhe grafikë me të dhëna për përdorimin mujor për përdorues celulare. Përdorimi mesatar mujor për përdorues është llogaritur sipas thirrjeve dalëse (thirrje që gjenerohen nga një përdorues) dhe thirrjeve hyrëse (thirrjet e marra nga një përdorues), të matura në minuta. Keta tregues janë llogaritur për të gjithë trafikun e gjeneruar dhe marrë gjatë periudhës (vit ose gjashtëmujor) pjestuar me numrin mesatar të përdoruesve gjatë periudhës (mesatarja e numrit të përdoruesve në fillim dhe në fund të periudhës). Thirrjet dalëse (hyrëse) përfshijnë thirrjet brenda rrjetit, drejt (nga) rrjeteve të tjera celulare, drejt (nga) rrjetet fikse dhe drejt (nga) ndërkombetare. Minutat e përdorimit (Minutes of Usage-MOU) është shuma e thirrjeve dalëse dhe hyrëse, që tregon se sa minuta ka shpenzuar një përdorues në komunikim zanor. Përdorimi mujor i SMS i referohet vetëm mesazheve të dërguar. Keto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhtme për të tre operatorët celulare.

Tabela 2: Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare 2006-2010/1

	2006		2007		2008			2009			2010/1		
	AMC	VF-AL	AMC	VF-AL	AMC	VF-AL	EAGLE	AMC	VF-AL	EAGLE	AMC	VF-AL	EAGLE
Thirrje dalëse në muaj	24.32	25.73	25.70	31.30	25.10	30.95	22.80	43.77	59.31	65.32	76.10	79.39	43.29
Thirrje hyrëse në muaj	46.29	49.20	46.28	52.09	45.88	50.39	22.38	58.81	74.20	71.71	86.63	91.52	51.38
MOU	70.60	74.92	71.99	83.39	70.97	81.34	45.17	102.58	133.51	137.04	162.72	170.92	94.67
SMS në muaj	5.99	10.58	7.23	15.21	6.82	15.09	5.40	9.5	15	12.4	8.42	13.37	1.14

Nga të dhënat duket qartë se përdorimi i shërbimeve celulare vazhdon të rritet ndjeshëm për AMC dhe Vodafone, me rritje 23-74%, ndërsa për Eagle rezultojnë të ketë reduktim të përdorimit mesatar me afërsisht 30%. Gjatë gjashtëmujorit të parë 2010, rezultojnë se përdoruesit celulare kanë kryer 44-79 minuta dalëse dhe 51-92 minuta të marra, apo 95-170 minuta komunikim në muaj me aparat celular për thirrje telefonike.

Në grafikët e mëposhtëm paraqitet treguesit në mënyrë grafike për secilin operator celulare.

Figura 12: Perdorimi Mesatar mujor per perdorues sipas operateveve 2006-2010/1






Tabela e mëposhtme paraqet përdorimin mesatar mujor të matur në numër thirrjesh si dhe kohëzgjatjen mesatare të thirrjeve celulare, nga ku vihet re se treguesit janë në rritje.

Tabele 3: Numri dhe kohëzgjatja mesatare e thirrjeve celulare në total (2009-2010/1)

	2009	2010/1
Thirrje dalese	48	50
Thirrje hyrese	51	54
Thirrje total	99	104
Kohëzgjatja mesatare e thirrjeve (sekonda):		
dalese	95	110
hyrese	109	119

III.5 Përdorimi shërbimeve të tjera celulare

1. Roaming Ndërkombëtar

Tabela e mëposhtme paraqet përdorimin e shërbimeve roaming, nga të cilat vihet re se:

- Numri i abonentëve të rrjeteve Shqiptare që kryejnë roaming është rreth 281 mijë apo 6.7% e përdoruesve celulare që është rreth tre herë më i vogël se numri i vizitorëve që kryejnë roaming në Shqipëri;
- Konsumi i shërbimeve gjatë kohës në roaming është i vogël përdorimi i tyre është përsëri më i vogël se përdorimi nga vizitorët e rrjeteve të huaja në Shqipëri.

Tabele 4: Përdorimi i shërbimeve roaming ndërkombëtar 2010/1

	2010/1
Përdorimi nga pajtimtarët e rrjeteve Shqiptare i Roamingut Nderkombetar	
Numri i pajtimtareve	281,205
Thirrje të gjeneruara dhe të marra (Minuta/muaj)	2,11
SMS të gjeneruara dhe të marra (Numer/Muaj)	0.80
Përdorimi nga pajtimtarët e rrjeteve të huaja gjatë Roamingut Nderkombetar në Shqipëri	
Numri i pajtimtareve	889,150

Thirrje te gjeneruara dhe te marra (Minuta/muaj)	3,10
SMS te gjeneruara dhe marra (Numer/muaj)	1.02

2. Shërbimi Internetit nga rrjeti celular

Numri i pajtimtarëve celularë (me kontratë dhe me parapagim) që kanë akses në Internet (GPRS/EDGE) nëpërmjet aparatit celular është mbi 1 milion përdorues, që përbën një rritje prej rreth 25% krahasuar me të dhënat e fund vitit 2009. AMC ka numrin më të madh të përdoruesve që përdorin Internetin me rreth 835 mijë abonente.

3. Mesazhe MMS

Përdorimi i shërbimeve MMS është në nivel shumë të kufizuar me rreth 575 mijë MMS të dërguara dhe të marra nga abonentët gjatë 6 muajve, që përbën shumë më pak se 1 MMS në 6 muaj.

III.6 Dimensionin e rrjeteve celulare

Tabela e mëposhtme parqet të dhëna mbi dimensionin e rrjeteve celulare për gjashtëmuajorin e parë 2010, për tregues të tillë si numri i BTS-ve, mbulimi me rrjet dhe numri i të punësuarve.

Tabele 5. Tregues të dimensionit të rrjeteve celulare 2010/1

	Njesia	AMC	VF-AL	EAGLE	Total
Numri i BTS per GSM	numer	464	430	363	1,257
Numri i MSC-ve	numer	3	3	1	7
Mbulimi i territorit me rrjet GSM	%	89.3	91.15	90	90
Mbulimi i popullsise me rrjet GSM	%	99.8	99.6	98	99
Numri total i punonjesve të sipërmarrësve me kohë të plote në shërbimet e k. elektronike	numer	535	407	263	1205

IV. TELEFONIA FIKSE

IV.1 Numri i pajtimtarëve dhe pjesët e tregut


Bazuar në të dhënat e regjistrimit të sipërmarrësve, në fund të 6 muajorit të parë 2010 (sipas regjistrimit të datës 01.07.2010), numri i sipërmarrësve që ofrojnë shërbime/rrjete të telefonisë fikse dhe shërbime të lidhura me to, është si më poshtë:

- Rrjete dhe shërbime të telefonisë fikse: 86
- Shërbim Interneti; 96
- Shërbime të thirrjeve me kartë të parapaguar; 22
- Thirrje telefonike me VOIP; 24
- Shërbim tranzitimi të thirrjeve; 33

Bazuar në të dhënat e operatoreve dhe vlerësimet e AKEP për 6 muajorin e parë 2010, rezulton se janë rreth 360 mijë pajtimtarë të telefonisë fikse, e cila është pothuajse e njëjtë me fund vitin 2009. Sipas të dhënave rezulton që Albtelcom ka një rënie në numrin e pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të 6 muajorit të I-re 2010, me afërsisht 5 mijë pajtimtarë ose rreth 1.9 % krahasuar me fund vitin 2009. Norma e penetrimit të telefonisë fikse vazhdon të jetë shumë e ulët në nivelin 11% (krahasuar me 45% në vendet e BE dhe të rajonit).

Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse të Albtelcom dhe operatorëve alternative paraqitet në figurën e mëposhtme. Ndër operatorët Alternative me numër më të madh abonentësh janë Nisatel, Primo, ASC dhe Mobitel të cilët kanë secili 3000-4500 abonentë.

Figura 13: Numri pajtimtareve të telefonisë fikse (2003-2010/1)



Struktura e pajtimtarëve të telefonisë fikse, Familjare dhe Të Tjerë, ka qenë e qëndrueshme në vite dhe gjatëmuajori i parë 2010 nuk paraqet ndryshime në këtë strukturë. Albtelecom ka rreth 21 mijë pajtimtarë Biznes (Të tjerë) dhe 265 mijë pajtimtare Familjare. Sipas të dhënave të raportuara, operatorët Alternative kanë rreth 1400 pajtimtare Biznesi.

Edhe pse ka një rënie të numrit të pajtimtareve të telefonisë fikse për Albtelecom, përsëri tregu i telefonisë fikse dominohet nga ky operator duke mbajtur rreth 79% pjesë tregu të linjave fikse.

Tabela 6. Pjesët e tregut të Albtelecom dhe Operatoreve Alternative

	Te ardhura (2009)	Pajtimtare	Trafiku dales
Albtelecom	83%	79%	90.42%
Operatoret Alternative	17%	21%	9.58%

IV.2. Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve të Albtelecom

Në tabelën 8, paraqiten disa tregues konsumi mujor të thirrjeve të përdoruesve të Albtelecom. Përdorimi është matur sipas trafikut total dalës dhe hyrës (thirrje të marra përfshijne edhe thirrjet brenda rrjetit Albtelecom, lokale dhe kombëtare), pjestuar me numrin mesatar vjetor të përdoruesve të Albtelecom. Rreshti i fundit paraqet totalin e minutave të komunikimit (Minutes of Usage-MOU) nga një përdorues i Albtelecom, thirrje dalëse dhe të marra.

Tabela 7 Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve të Albtelecom 2003-2010/1

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010/1
Thirrje dalese	296	187	227	239	180	162	168	164
Lokale dalese	256	154	193	206	149	136	112	126
Mobile	14	12	13	12	12	11	10	8
Kombetare drejt fiks	18	12	13	13	12	9	41	26
Nderkombetare	9	9	9	7	7	6	5	4
Thirrje të marra	314	207	242	255	205	191	181	226
MOU	610	394	469	493	385	353	349	390

Mesatarisht konsumi i thirrjeve të kryera është 164 minuta në muaj thirrje dalëse si dhe 226 minuta në muaj thirrje të marra, që do të thotë që një përdorues i Albtelecom gjatë vitit 2010/1 ka shpenzuar mesatarisht 390 minuta apo afërsisht 6.5 ore në komunikim me

telefon fiks. Treguesit e MOU per 6 mujorin e I-re 2010, tregojne një rritje te përdorimit mesatar mujor të shërbimeve të Albtelecom nga përdoruesit e tij.

V. INTERNETI

V.1. Numri i pajtimtarëve me akses broadband në Internet dhe struktura e tyre

Deri në fund të gjysmës së parë të vitit 2010 janë rreth 96 sipërmarrës që kanë njoftuar AKEP për ofrimin e shërbimit të aksesit në Internet. Gjate gjysmës së parë të vitit 2010, ofrimi i shërbimeve të Internetit në brez të gjerë (broadband) vazhdoi rritjen e ndjeshme të numrit të pajtimtarëve si dhe rritjen e numrit të ofertave dhe reduktimin e tarifave.

Sipas të dhënave më të fundit nga operatorët dhe vlerësimeve të AKEP numri i familjeve që kanë akses në Internet me bandë të gjerë (broadband) është rreth 100 mijë apo afërsisht 12.5 % e familjeve, ndërsa vlersohen të jeni mbi 10 000 pajtimtarë biznesi.

Bazuar në këto të dhëna, numri i linjave broadband për 100 banorë është rreth 3.4%, krahasuar me 2.5% që ishte në fund të vitit 2009.

Ndarja e tregut për ofruesit e shërbimit të Internetit, ndërmjet Altelecom dhe ofruesve të tjerë të këtij shërbimi, (bazuar në të dhënat e Altelecom si dhe në një vlerësim të AKEP për të dhënat e ofruesve të tjerë të këtij shërbimi), rezulton që Altelecom zotëron rreth 54% pjesë tregu bazuar në të ardhurat e këtij shërbimi si dhe rreth 63.5 % pjesë tregu bazuar në aksesin e ofruar në këtë shërbim.

Numri i pajtimtarëve (lidhjeve) broadband nëpërmjet ADSL të Altelecom, deri në fund të gjysmës së parë të vitit 2010 është rreth 60 mijë pajtimtarë nga të cilët rreth 7% të tyre janë pajtimtarë biznes, kurse të tjerët janë pajtimtarë familjare. Të dhënat e 6 muajit të I-re 2010 për shërbimin e Internetit tregojnë për një rritje në total rreth 13.5% të Altelecom, krahasuar me fundin e vitit 2009.

Në tabelën e mëposhtme, paraqiten të dhënat sipas raportimeve nga 27 ofrues Interneti (nga 96 të autorizuar), dhe vlerësimi i AKEP për numrin e abonentëve me akses broadband në Internet.

Tabela 8. Numri i pajtimtarëve me akses broadband në Internet (2010/1)

	Alternative	Albtelecom	Total (raportimi i operatoreve)	Total (vleresimi i AKEP)
Numri pajtimtareve me akses broadband	28956	59600	88556	110.000
pajtimtare familjare	24866	55485	80351	100.000
pajtimtare biznes	4090	4115	8205	10.000

Teknologjia kryesore vazhdon të jetë ADSL dhe operatori kryesor është Albtelecom, i cili ka qenë shumë aktiv në shërbimet e aksesit në Internet, nëpërmjet investimeve në rrjetin lokal për të mundësuar ofrimin e shërbimit broadband nëpërmjet ADSL dhe reduktimit të tarifave për këtë shërbim. Nga të dhënat e raportuara vihet re se një numër i konsiderueshëm i lidhjeve broadband nga operatorët alternativë kryhet me kombinim fibër optike, kabëll koaksial apo linjë bakri. Ndërkohe rreth 10% e abonentëve ADSL të Albtelecom përfitojnë akses në Internet me MSAN, e cila mund të konsiderohet si FTN (Fiber To the Node).

Numri i abonentëve të Albtelecom që përdorin Internet me Dial up ka rënie të ndjeshme duke arritur në rreth 2 mijë, krahasuar me 14 mijë në fund të vitit 2009. Kjo rënie mund të shpjegohet me rritjen e ndjeshme të alternativave për akses broadband në Internet.

Në këtë periudhë edhe operatorët celularë kanë qenë shumë aktivë në ofrimin e shërbimeve të Internetit nëpërmjet aparateve celulare dhe kartave modem për PC, duke ofruar reduktime të ndjeshme të tarifave të këtij shërbimi për përdorues me kontratë dhe me parapagim. Në fund të gjashtëmujorit të parë 2010, numri i pajtimtarëve celularë (me kontratë dhe me parapagim) që kanë akses në Internet nëpërmjet aparatit celular është mbi 1 milion përdorues, që përbën një rritje prej rreth 25% krahasuar me të dhënat e fund vitit 2009.

Gjatë gjashtëmujorit të parë 2010, janë vënë re dhe disa ndryshime cilësore në ofrimin e aksesit broadband në Internet:

- **Albtelecom:**
 - ♦ Rritje e shpejtësisë së aksesit në Internet broadband ADSL:
 - Minimumi 256kbps në Minimum 2 mbps
 - Maksimum 2 Mbps në maksimum 12 Mbps
 - Shpejtësia më e përdorur nga 256 kbps në 2 mbps

- ◆ Reduktimi i tarifave nëpërmjet konvertimit/update në shpejtësi më të lartë.
- Operatorët alternativë:
 - ◆ Rritje e shpejtësisë së aksesit broadband
 - ◆ Shpejtësia më e përdorur nga 256 kbps në 1 mbps
 - ◆ Ofrimi i paketave të kombinuara: Internet, TV dhe Telefoni
 - ◆ Reduktimi i tarifave

Tabela 9. Klasifikimi i pajtimtarëve me akses broadband sipas teknologjive 2010/1

	Alternative	Albtelecom	Total
DSL (mbi linje bakri)	19029	59567	78596
Kombinim Fiber/kabell koaksial/linje bakri:	15000	5373	18527
Shpejtësia e aksesit në Internet	256 kbit/s- 20 Mbit/s	2 Mbit/s-12 Mbit/s	
Shpejtësia më e përdorur	1 Mbit/s	2 Mbit/s	
Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara	0	59621	59621
TV dhe Internet	215	0	215
Internet dhe Telefoni	4489	59621	64110
TV dhe Telefoni	0	0	0
TV, Internet dhe Telefoni	125	0	125

V.2. Ofrimi me shumicë i aksesit në Internet dhe infrastruktura

Në tabelën e mëposhtme paraqiten disa të dhëna për ofrimin e aksesit në Internet në nivel me shumicë (ofrimi për Hotspot, Internet kafe dhe lidhja me Boten) si dhe infrastrukturën e ndërtuar nga operatorët Alternative dhe Albtelecom. Nga të dhënat vihet re se konektiviteti

me Internetin Global është rritur nga rreth 6 Gbps në fund të vitit 2009 në 12 Gbps në fund të gjashtëmujorit të parë 2010.

Tabela 10. Ofrimi i aksesit në Internet në nivel me shumicë 2010/1

	Alternative	Albtelecom	Total
Numri i pikave publike ëireless (ËLAN apo ËiFi Hotspots)	1319	0	1319
Numri i Internet Kafe	208	533	741
Konektiveti me Internetin Global (nderkombetar)	5 Gbps	6.2 Gbps	12 Gbps
Fibër Optike e instaluar			
kapaciteti	4581 Mbit/s		
gjatësia	498 km	1530 km	2028 km
Lidhje me radiofrekuenca mikrovalore			
kapaciteti	1713 Mbit/s		
gjatësia	835 km	1964 km	2799 km